

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"BelKos AI" sh.p.k

Sot, me date **02.08.2021**, mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise, te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe te ligjit 131/2015 date 26.11.2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", me vullnetin e tij te lire, te shprehur edhe me nenshkrimin e ketij Akt Themelimi ortaku themelues :

1. **Z. Shkelzim Sulejmani** i biri i Qerkin-it, i datelindjes 08.06.1988, lindur ne Prishtine, dhe banues ne Kosove, me adrese Ruga "Xhemajl Mustafa" blloku 3, nr.55, Fushe-Kosove, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me ane te pasaportes nr.P01361854., ne cilesine e ortakut themelues

Vendos te kriroje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "BelKos AI" sh.p.k me akt themelimi si vijon:

EMERTIMI

NENI 1

1.1 Formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar e quajtur "BelKos AI" sh.p.k.

1.2 Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit te vendit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

2.1 Shoqeria e ka qendren ne Rruga e "Prushit" nr.1, Njesia Administrative Vaqarr/Tirane, ne pasurine e paluajtshme me nr. pasurie 296/72+1-6, e cila ndodhet ne Zonen Kadastrale nr.3712, e regjistruar ne Zyren Vendore te Agjencise Shteterore te Kadastres Tirane, dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

2.2.Njesite strukturore, deget dhe perfaqesite do te ndertohen konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ate te vendeve te tjera ku ajo mund te hape dege.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:



- 3.1. Punesimit, furnizimin e bizneseve me personel me kontrate me afat ose pa afat per zhvillimin e cdo lloj aktiviteti tregtar ne Repubiken e Shqiperise dhe jashte saj.
- 3.2. Ndermjetesim ndermjet ofertes dhe kerkeses per pune. Kerkimin dhe perzgjedhjen e personelit per te permbushur kerkesen specifike te klientit. Formimin dhe trajnimin e stafit sipas nevojave te klientit. Mbeshtetje per zhvendosjen e stafit.
- 3.3.Kryerjen e sherbimeve ne fushen e kerkimit, formimit dhe specializimit te personave qe perfshin; inxhinieret e licensuar te te gjitha fushave, specialisteve te ndryshem ne fushen e ndertimit te c'faredo kadeqorie dhe niveli, shofereve, personel hotelerie dhe punonjes te fushave te sherbimit, te kualifikuar me synimin per ti punesuar ata prane kompanive qe operojne ne Republiken e Shqiperise dhe jashte Shqiperise.
- 3.4.Sherbimet e konsulences per furnizim profesional te te punonjesve me kohe te percaktuar dhe te pacaktuar, brenda dhe jashte vendit.
- 3.5.Aktivitet i identifikimit te pozicioneve te punes, ndermjetesimit, hetimit dhe perzgjedhjes se personelit, trajnimit profesional dhe zhvillimit te workshop-eve mbi aktivitetet e ndryshme profesionale.
- 3.6.Se fundi, shoqeria "BelKos AI" sh.p.k do te kryeje cdo aktivitet tjetër te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te shoqerise qe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin e brendshem shqiptar.
- 3.7.Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga Asambleja e Ortakeve.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 4

4.1 Shoqeria "BelKos AI" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.B.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

5.1. Kapitali i shoqerise "BelKos AI" sh.p.k perbehet nga para me nje vlere te barabarte me 10 000 leke. Ky kapital ndahet ne 1 kuote e cila zoterohet nga **Ortaku i Vetem, z.Shkelzim Sulejmani**.



- 3.1. Punesimit, furnizimin e bizneseve me personel me kontrate me afat ose pa afat per zhvillimin e cdo lloj aktiviteti tregtar ne Repubiken e Shqiperise dhe jashte saj.
- 3.2. Ndermjetesim ndermjet ofertes dhe kerkeses per pune. Kerkimin dhe perzgjedhjen e personelit per te permbushur kerkesen specifike te klientit. Formimin dhe trajnimin e stafit sipas nevojave te klientit. Mbeshtetje per zhvendosjen e stafit.
- 3.3. Kryerjen e sherbimeve ne fushen e kerkimit, formimit dhe specializimit te personave qe perfshin inxhinieret e te gjitha fushave, specialisteve te ndryshem ne fushen e ndertimit, shofereve, personel hotelerie dhe punonjes te fushave te sherbimit, te kualifikuar me synimin per ti punesuar ata prane kompanive qe operojne ne Republikën e Shqiperise dhe jashte Shqiperise.
- 3.4. Sherbimet e konsulences per furnizim profesional te te punonjesve me kohe te percaktuar dhe te papercaktuar, brenda dhe jashte vendit.
- 3.5. Aktivitet i identifikimit te pozicioneve te punes, ndermjetesimit, hetimit dhe perzgjedhjes se personelit, trajnimit profesional dhe zhvillimit te workshop-eve mbi aktivitetet e ndryshme profesionale.
- 3.6. Se fundi, shoqeria "BelKos AI" sh.p.k do te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te shoqerise qe nuk bie ne kundertshtim me legjislacionin e brendshem shqiptar.
- 3.7. Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga Asambleja e Ortakeve.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE NENI 4

- 4.1 Shoqeria "BelKos AI" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.B.

KAPITALI I SHOQERISE NENI 5

- 5.1. Kapitali i shoqerise "BelKos AI" sh.p.k perbehet nga para me nje vlere te barabarte me 10 000 leke. Ky kapital ndahet ne 1 kuote e cila zoterohet nga Ortaku i Vetem, z. Shkelzim Sulejmani.



5.2. Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

5.3. Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejte te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre. Ne rast se nje apo disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset qe i rezervohen atij/atyre ne rritjen e kapitalit mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

5.4. Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufirin qe percakton ligji. Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

ORGANI VENDIMARRRES NENI 6

6.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise, qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

6.2. Asambleja e Ortakeve, vendos per çeshtje si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve;
- d) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- g) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- h) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise etj.

6.3. Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve duhet te regjistrohen ne librin e procesverbaleve sipas nenit 90 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 7

7.1 Administrator i shoqerise do te jete z. Shkelzim Sulejmani i biri i Qerkin-it, i datelindjes 08.06.1988, lindur ne Prishtine, dhe banues ne Kosove, me adrese Ruga "Xhemajl Mustafa" blloku 3, nr.55, Fushe-Kosove, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me ane te pasaportes nr.P01361854.

7.2. Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 2 vjeçar me te drejte ripertitje bazuar ne nenin 95/1 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

7.3. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

NENI 8

KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

8.1. Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve dhe t'i paraqesi per miratim tek Asambleja e Ortakeve vetem i shoqerise,;
- d) krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) te kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) te raportoje perpara ortakut te vetem ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

8.2. Administratori eshte i detyruar t'i beje thirrje ortakut te vetem qe te marre vendim, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

8.3. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve.

8.4. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

8.5. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e tij.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove

e mjaftueshme.

NENI 9

9.1.Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.

9.2.Ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 10

10.1 Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

NENI 11

11. 1 Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr. 9901 date, 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

NENI 12

Ky Statut u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte juridike.

ORTAKU I VETEM

Z.Shkelzim Sulejmani

shkelzim sulejmani

